



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05Nr.391/02-211708/23 dt.26.10.2023, të kërkuësve/bashkëpronarëve, Valdet Shaqiri nga Prishtina me investitorë “Luxuri Invest” shpk me seli në Fushë Kosovë, rr. “Pajazit Islami”, pn. për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën afariste, të ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në rr. “Lidhja e Pejës” dhe “Aziz Abrashi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 09.08.2024, lëshon këtë:

## CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

**I. I LEJOHET** kërkuësve / bashkëpronarëve, Valdet Shaqiri nga Prishtina me investitorë “Luxuri Invest” shpk, me seli në Fushë Kosovë, rr. “Pajazit Islami”, pn., sipas kërkesës 05Nr.391/02-211708/23 dt.26.10.2023, përdorimi i ndërtesës afariste, me etazhitet 2B+S+P+2, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore”, 05Nr.351-149249/19 dt.07.11.2019, dhe “Vendimi për miratim të ndryshimit dhe plotësimit të dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, të miratuar me vendimin 05Nr.351/02 – 149249/19 dt.07.11.2019”, 05Nr.351/02-186179/22 dt.06.02.2023, në parcelën kadastrale nr. 10471-0, e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71914059-10471-0, ZK Prishtinë, konkretisht në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë.

**II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Lidhja e Pejës”, ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 324 dhe 326, dhe “Aziz Abrashi” ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrin: 132, në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

**III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

**VI.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

### A r s y e t i m

Kërkuësit / bashkëpronarët, Valdet Shaqiri nga Prishtina me investitorë “Luxuri Invest” shpk, me seli në Fushë Kosovë, rr. “Pajazit Islami”, pn., me kërkesën me 05Nr.391/02-211708/23 dt.26.10.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën afariste, me etazhitet 2B+S+P+2, e ndërtuar në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10471-0, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore”, 05Nr.351-149249/19 dt.07.11.2019, dhe “Vendimi për miratim të ndryshimit dhe plotësimit të dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, të miratuar me vendimin 05Nr.351/02-149249/19 dt.07.11.2019”, 05Nr.351/02-186179/22 dt.06.02.2023, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-97651/23 dt. 24.11.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografitë gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Përparim Fazliu; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Sami Idrizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjetllësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Muhedin Morina; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Bekim Beqiri; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Gazmend Krasniqi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania gjeodete e licensuar "Geomatika-arch", me nr. të licensës 1;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjetllësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa afariste mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa afariste mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën afariste.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

**Udhëzimi juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, përmes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

**I dorëzohet:** Kërkesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZIMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 391/02-211708/23 DT. 09.08.2024**

Zyrtarja,  
Bahtije Vllasaliu  
*B.V. Vllasaliu*

Udhëheqëse e Sektorit  
Nazife Krasniqi

Faqe 2 prej 3